



**Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
- Kuvendi i Komunës-
01. Nr. 400-17800/11
Kaçanik; 28.12.2011**

Në bazë të nenit 12, 24 dhe 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 30 të Ligjit nr.03/L-048. – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 2 dhe 7 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, të nenit 14 të Ligjit nr.04/L-001- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, të nenit 4. të Vendimit 01-nr.05-5316/10. - Për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2011 dhe Vlerësimet për vitet 2012-2013 të datës 24.09.2010, si dhe nenit 34.5 dhe 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28.12.2011, mori këtë:

V E N D I M PËR TRANSFERIN E MJETEVE DHE HARMONIZIMET NGA NDARJET BUXHETORE TE BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2011

I.

Me këtë vendim lejohet transferi intern i mjeteve dhe harmonizimet te ndarjet buxhetore me Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin 2011, përkatësisht realizimi i procesit të ndryshimeve dhe plotësimeve te programet – nënprogramet në organizatën buxhetore brenda për brenda kategorisë së Pagave dhe Mëditjeve.

II.

Me ndryshimet dhe përshtatjet e reja konform pikës I. të këtij vendimi, do të bëhen transferet interne dhe harmonizimet e nevojshme në programet dhe nënprogramet buxhetore brenda kategorisë ekonomike të Pagave dhe Mëditjeve, ashtu siç janë pasqyruar në tabelarin e bashkangjitur, i cili është pjesë përbërse e këtij vendimi – Tabela 4.1. – Transferi Intern i mjeteve dhe Harmonizimet te kategoria e Pagave dhe Mëditjeve.

III.

Obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit që më Departamentet të MF-së të bëjë harmonizimin dhe zbatimin e këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve buxhetore sipas këtij vendimi.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, dhe
- Arkiva.

**Kryesuesi i Kuvendit,
z. Xhelal Gashi**
